

Natura 2000 është rrjetë e rajoneve të mbrojtura i cili përfshinë llojet, vendbanimet dhe shpendët më të rëndësishme dhe më të rrezikuara në Evropë.

Natura 2000 nuk paraqet system të rezervateve rreptërisht natyrore ku përjashtohen të gjithë aktivitetet njerzore. Qasja ndaj mbrojtjes dhe shfrytëzimit të qëndrueshëm të resurseve natyrore me të cilët pronëson një rajon i Natura 2000 është shumë i gjërë dhe kryesisht mbështetet mbi njerëzit që punojnë në natyrë, jo kundër saj.

Është e nevojshme të menaxhohet me rajonin e mbrojtur në mënyrë të qëndrueshme ekonomike dhe ekologjike.



Mësoni më shumë për Natura 2000
<http://natura2000.eea.europa.eu/#>



Mësoni më shumë për projektin:
<http://natura2000.gov.mk/>



Për pyetje kontaktoni në info@natura2000.gov.mk

Ky botim është punuar me ndihmën e Bashkimit Evropian. Për përmbajtjen e këtij punimi përgjegjës janë vetëm Sektori për natyrë i MMJPH, SYKE ose konzorciumi dhe i njëjti jo domosdoshmërisht reflekton qëndrimet e Bashkimit Evropian.

Autorët e fotografive: Përfaqësues të Sektorit për natyrë– MMJPH, PN Pelister dhe twining projekt.

NATURA 2000

Për natyrën
 Për njerëzit



Rajoni potencial i Natura 2000
 Parku nacional PELISTER




„Përforcimi i kapaciteteve për zbatimin efektiv të legjislacionit evropian në fushën e mbrojtjes së natyrës”



Ky projekt është financuar nga Bashkimi Evropian.

Pelisteri është parku i parë nacional në Republikën e Maqedonisë së Veriut. I fshehur nga pjesa e mbetur e tokës, me peizazhe natyrore që të mahnisin, Parku nacional ofron kënaqësi të plotë për adhuruesit e natyrës. Ai është shumë i rëndësishëm jo vetëm në nivel nacional, por edhe në atë evropian dhe botëror.

Duke u shtrirë në një sipërfaqe prej 17.150 hektar, Parku Nacional Pelister zë një hapësirë të madhe e cila është e begatshme me bukuri të jashtëzakonshme natyrore, me natyrë shumë të mbrojtur, gjediversitet dhe biodiversitet të pasur, lumej malor dhe zona të dendura malore të cilat gërshetohen në të.



Harta e
PN Pelister

PN Pelister është përfshirë në këto regjime ndërkombëtare vijuese të mbrojtjes:

- Rrjeti kombëtar Emerald i rajoneve me interes të veçantë për mbrojtje e BE (ASCI), të cilat përcaktohen sipas detyrave të shtetit në raport me konventën e Britanisë.
- Rezervati biosferik ndërkombëtar Ohër-Prespë, i vendosur në përputhje me Programën e UNESCO-s “Njeriu dhe Biosfera”.
- Parku është identifikuar si rajon i rëndësishëm bimor në përputhje me kriteret e Plant Life International.



Relievi i përfaqësuar ose përshkruar me male, brigje, rafshira, lumej, kullota dhe të tjera, në çdo rajon të Natura 2000 e definojnë tipin e aktivitetit që do të praktikohet atje.

Aktivitetet e rekomanduara në rajonin e ardhshëm të Natura 2000 PN Pelister:

- Sport
- Rekreacion
- Hulumtim
- Terapi artstres
- Vëzhgim
- Ekoturizmi
- Bujqësi dhe blegtori tradicionale
- Skijim
- Ngjitja në male
- Peshkimi sportiv
- Alpinizëm
- Paraglajderizm
- Biçiklizmi
- Ushqim i shëndoshë shtëpiak

Direktivat për vendbanimet dhe shpendët në BE vendosin kornizën ligjore për veprim, por lënë hapësirë që çdo vend anëtar të vendos se si më së miri të menaxhoj me rajonet e tyre Natura 2000, në konsultim me palët e përfshira lokale. Duke pasur parasysh faktin që Natura 2000 ka karakteristikat e saj specifike në çdo vend, nuk ekziston asnjë model i cili njëlloj përshtatet për menaxhimin e tërë rajoneve.

Jepni kontributin tuaj në mbrojtjen e vlerave natyrore të Parkut Nacional Pelister!

Bëhuni të vetëdijshëm, silluni me përgjegjësi!

- Është shumë e vështirë të shuhet një zjarr në mal, andaj MOS E NDIZNI! Zjarri vret ose shkatron gjithçka që i del përpara.
 - Mund të mblidhni të dhëna për llojet dhe vendbanimet e mbrojtura në rajonin e mbrojtur.
- Merrni pjesë!**
- Organizoni fushatë për familjen, miqtë dhe bashkësinë tuaj për pastrimin e mjedisit.

Bëhuni aktiv!

- Kyçuni në turizmin alternativë në Malovishte dhe fshatrat tjerë afër Parkut Nacional. Të jetohej në fshat dhe të kultivohen zakonet tradicionale, jo vetëm që është interesant, por është e dobishme për natyrën dhe për Ju.
- Lexoni më shumë bujqësi në Natura2000!




Natura 2000 mbështet mbi parimin e ndërtimit të partneritetit në nivel lokal dhe ngritjen e vetëdijes publike me qëllim që të nxitet pjesëmarrja e individit në proceset e planifikimit dhe menaxhimit me Natura 2000 dhe rajonet e mbrojtura.

Si rezultat i përbërjes gjeologjike, terrenit specifik dhe klimës malore në park janë formuar lloje të ndryshme të vendbanimeve të cilat shquhen me biodiversitet të begatshëm dhe të rëndësishëm. Më të shprehura dhe më të rëndësishme janë pyjet me arneni (Pinus peuce) – molika. Parku Nacional Pelister është fole e nëntë llojeve endemike dhe i një numëri të madh të luleve dhe llojeve të rrezikuara.



Sipërfaqet acidofile oromezike me bar (62D0)

Ky lloj vendbanimi gjendet në si shtojcë I i Direktivës për vendbanime, sepse ka rëndësi të madhe.



Parku nacional Pelister i përmban të gjithë llojet themelore të ekosistemeve të cilat zakonisht hasen në vend: ekosistemet pyjore dhe me bar, atë malor dhe ujor.

Në kornizën e këtyre ekosistemeve gjenden lloje të ndryshme të vendbanimeve, duke filluar nga shkurret dhe kaçubet, bashkësitë pyjore gjedhrëse (dushku dhe ahu) dhe halore (pishat), e deri te bashkësitë subalpine dhe alpine të barit, si dhe bashkësitë që hasen pranë rrjedhjeve ujore dhe pranë vendbanimeve të ndryshme ujore.



Shkurret alpine dhe boreale janë tip i shpeshtë i vendbanimit në PN Pelister

Me rëndësi të veçantë janë bimët endemike të cilat hasen vetëm në kufijtë e PN Pelister:

- Lulebora e Pelisterit (*Crocus pelistericus*)
- *Alkemila e Pelisterit* (*Alchemilla pelisterica*)



Lulebora e Pelisterit (*Crocus pelistericus*)

Vendbanimet shkëmbore janë të shpeshta dhe karakteristike për PN Pelister. Te ky tip përfshihen të gjithë siparet silikate në rrafshnaltat e Evropës së Mesme.



“Lumejtë guror” të njohur në PN Pelister i përkasin këtij tipi të vendbanimit. Siparet silikate janë shumë të rëndësishme sidomos për likenë dhe myshk, si dhe për fieret, të cilat përfshijnë lloje të rralla me përhapje boreale dhe alpine.



Lugina e Lumit Magarev



Fieri alpin-*Dryopteris expansa*

EKOSISTEMET E UJËRAVE TË ËMBLA NË PARKUN NACIONAL PELISTER

Liqenet glaciale, burimet malore, përruat dhe lumejtë janë shumë të rëndësishëm për shumë lloje endemike dhe të rralla. Liqenet glaciale poashtu kanë vlerë të lartë estetike.



Trofta e Pelisterit (*Salmo peristericus*)



Pilivesa (*Cordulegaster heros*)



Mëllenja e ujit (*Cinclus cinclus*)



Bishtatundësi i përhimë (*Motacilla cinerea*)



Ekosistemi i Liqenit të Madh është ekosistem i cenueshëm mbi të cilin numëri i rritur i vizitorëve mund të ketë ndikim negativ.

Prandaj, nëse dëshironi ta ruani këtë liqen unikat për gjeneratat e reja, kënaquni, çlodhuni dhe bëhuni të përgjegjshëm për veprimet tuaja në natyrë!

EKOSISTEMET MALORE NË PARKUN NACIONAL PELISTER

Në parkun nacional Pelister pyjet zënë një sipërfaqe prej 5.672 hektar. Te këto pyje hasen nëntë tipe të bashkësive malore, nga të cilat dy janë molikë (*Pinus peuce*), katër prej ahu (*Fagussylvatica*) tre prej dushku (*Quercusspp*).

Këto pyje ose male janë vendbanime të rëndësishme për shumë lloje të rrezikuara ose të rralla të gjallesave, për shkak të të cilëve kanë rëndësi të madhe socio-ekonomike.

91AA* Pyje lindore me dushk të bardhë

*Vendbanimet me përparsi, ose llojet të cilëve ju kanoset rrezik nga zhdukja kanë edhe trajtim të veçantë në tërë Evropën.



Antenagjati (*Rosalia alpina*)



Acadreni (*Lucanus cervus*)



Cefalanter gjethgjatë (*Cephalanthera longifolia*)



Qikapiku larosh (*Dendrocopus medius*)



Pyjet e PN Pelister janë fole e shumë llojeve të gjahut të madh, sidomos i ariut.

Kur shëtisni nëpër pyll mos harroni se jeni mysafir te ata andaj silluni me përgjegjshmëri.

PYLLI ME MOLIKË NË PARKUN NACIONAL PELISTER

Parku nacional Pelister njihet me pyllin e saj molikë. Pisha-molikë, formon dy bashkësi bimore në parkun nacional:

- Pylli gorska me molikë (*Digitali viridi orae-Pinetumpeuces*)
- Nën pyllin e lartë (në rrëzë malit) me molikë (*Gentiano luteae-Pinetumpeuces*)

Molika paraqet një nga fenomenet më të rëndësishme dhe më interesante biogeografike, ekologjike dhe vegjetative në Gadishullin Ballkanik.



Pylli me molikë – pamje nga lokaliteti Guri i Dallëndyshes.



Kablësh Molike

Gjilpërat më shpesh janë me gjatësi prej 6–11 cm, kurse kablëshka ka gjatësi prej 8-16 cm, edhe pse ndonjëherë arrin deri në 20 cm. Kur është e re, kablëshi është i gjelbër, kurse kur pëqet ngjyrën e ndryshon në të verdhë-kafe me lëvizha të mëdha të sheshta ose pak të rrumbullakëta. Farat më shpesh janë 6-7 mm të gjata, kanë krahë të gjatë 2 cm dhe përhapen me ndihmën e erës ose nga shpendët pastruese.

TIPET E NDRYSHME TË SIPËRFAQEVE ME BAR NË PARKUN NACIONAL PELISTER

Bashkësitë e kullotave, sidomos kullotat alpine në pjesët më të larta të malit përfshijnë një numër të madh të bashkësive endemike maqedonase dhe ballkanike. Ata mes tjerash kanë rëndësi të madhe shkencore dhe socio-ekonomike dhe karakterizohen me vlerë të lartë estetike.

Kushtoni vëmendje llojeve karakteristike:



Sipërfaqet acidofile oromezike të kullotave (*Oromoesian acidophilous*) - 62D0
Sipërfaqet dhe shkurret e thata gjysmënatyrore të kullotave

Kullojta e dhenëve ka një traditë të gjatë në malin Baba dhe në kaluarën ka qenë një aktivitet më i rëndësishëm ekonomik për pjesën dërmuese të bashkësisë lokale. Kullotat kanë dobi nga blegtoria tradicionale, sepse ashtu mbahet biodiversiteti. Andaj edhe Bashkimi Evropian financiarisht e mbështet blegtorinë në rajonet e Natura 2000.

Bëhuni blegtor!



Karafili i shtrirë
(*Dianthus myrtinervius*)



Flutura e kaltër pastruese
(*Maculinea arion*)

